

RELACION

I PROJEKTLIGJIT

“PËR STRATEGJINË DETARE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është hartuar si pjesë e paketës ligjore në kuadër të përafrimit të plotë të legjislacionit Shqiptar në fushën e menaxhimit të burimeve ujore me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë nëpërmjet mbështetjes së projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri”, financuar nga BE dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Një nga komponentët e këtij projekti është “Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”. Një nga detyrimet e përafrimit të legjislacionit evropian në fushën e burimeve ujore është implementimi i Direktivës 2008/56/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datë 17 qershor 2008, për përcaktimin e kuadrit të veprimit në fushën e politikave mjedisore detare, ndryshuar nga direktiva (EU) 2017/845 e 17 maj 2017 dhe vendimi i Komisionit 2010/477/EU.

Procesi i përafrimit ka kaluar në dy faza. Në fazën e parë është bërë identifikimi i legjislacionit të BE-së në fushën e ujit, analizimi i legjislacionit shqiptar, krahasimi i dy legjislacioneve, identifikimi i mangësive në legjislacionin shqiptar dhe hartimi i raportit me rekomandimet përkatëse. Në fazën e dytë është bërë hartimi i planit për përfshirjen e direktivave në legjislacionin vendas, krijimi i strukturës së normave ligjore, hartimi i normave të reja ligjore dhe hartimi i akteve nënligjore përkatëse.

Si rezultat i dy fazave u bë hartimi i neneve të projektligjit “Për Strategjinë Detare të Republikës së Shqipërisë”. Në kuadër të finalizimit të paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.24, datë 9.02.2021, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore” i cili filloi punën në prill të vitit 2021 e vijoi edhe gjatë vitit 2022.

Ky projektligj ka si qëllim të përcaktojë kuadrin ligjor për arritjen dhe mirëmbajtjen e një statusi të mirë mjedisor të ujërave detare të Detit Mesdhe, të cilat janë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, përmes hartimit e zbatimit të Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë.

Projektligji synon të arrijë këto objektiva:

- (a) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar;
- (b) parandalimin e përkeqësimit të mjedisit detar;
- (c) restaurimin e ekosistemeve detare që janë prekur negativisht; si dhe
- (ç) parandalimin dhe uljen e hedhjeve në mjedisin detar, me qëllim eliminimin gradual të ndotjes, siç përcaktohet në nenin 2 të këtij projektligji, për të siguruar që nuk ka ndikime apo rreziqe të rëndësishme ndaj biodiversitetit detar, ekosistemeve detare, shëndetin e njeriut apo përdorimet e ligjshme të detit.

Strategjia detare duke zbatuar një qasje të bazuar tek ekosistemet në lidhje me menaxhimin e veprimtarive njerëzore, siguron që trysnia e veprimtarive të tilla mbahet në nivele në përputhje me arritjen e statusit të mirë mjedisor dhe që kapaciteti i ekosistemeve detare për t'iu përgjigjur ndryshimeve të bëra nga dora e njeriut nuk kompromentohet, duke bërë të mundur njëkohësisht përdorimin e qëndrueshëm të mallrave dhe shërbimeve detare nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Fusha e Menaxhimit të Ujërave është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integrit, detyrimet e së cilës përcaktohen në nenin 70/3 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili parashikon domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*”. Ndërkohë që, neni 108 i MSA-së vë theksin në zhvillimin dhe bashkëpunimin e palëve me qëllim që të promovojnë qëndrueshmërinë mjedisore.

Projektligji është parashikuar në PKIE 2022-2024, Kapitulli 27, “Mjedisi”, fusha “Cilësia e ujit”.

Projektligji është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2022 (sipas Vendimit nr.850, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, planifikuar për katërmujorin e tretë të vitit.

Menaxhimi i integruar i ujit është një ndër prioritetet e qeverisë shqiptare. Ky prioritet theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016).

Gjithashtu ky projektligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, ku përcaktohet se objektivi për arritjen e detyrimeve që vijnë nga Bashkimi Evropian në sektorin e ujit është fillimisht nëpërmjet hartimit të një legjislacioni.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Projektakti synon rregullimin e të gjitha çështjeve që lidhen Planin e Veprimit të Hartimit të Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë, elementët përkatëse, institucionet përgjegjëse, hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë, përcaktimin e institucioneve përgjegjëse etj.

Me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor përkatës dhe duke konsideruar rëndësinë e përafrimit të plotë të legjislacionit në fushën e menaxhimit të burimeve ujore me atë të Bashkimit Evropian propozohet miratimi i këtij projektligji.

Ky projektligj synon:

- Përcaktimin e kuadrit ligjor dhe institucional për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë;
- Përcaktimin e elementëve që duhet të përmbajë Strategjia Detare;
- Përcaktimin e kuadrit ligjor dhe përgjegjësive institucionale për hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë;
- Përcaktimin e rregullave për vlerësimin fillestar të ujërave detare;

- Përcaktimin e rregullave për përcaktimin e statusit të mirë mjedisor të ujërave detare dhe treguesve për monitorimin e arritjeve të tyre;
- Përcaktimin e rregullave për përcaktimin e objektivave mjedisore;
- Përcaktimin e rregullave për programet e monitorimit për vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor të këtyre ujërave,
- Garantimin e përfshirjes së publikut në informacionin mjedisor, sipas legjislacionit përkatës dhe për të marrë pjesë në zbatimin e kërkesave të këtij projektligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Ky projektligj hartohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Projektvendimi është në përputhje me Direktivën 2008/56/EC 2008/56/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 17 Qershor 2008 “Për krijimin e kuadrit për veprimet e komunitetit në fushën e politikave mjedisore detare”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE).

Projektligji synon që nëpërmjet tij dhe akteve nënligjore në zbatim të tij të bëhet transpozimi i plotë i direktivës së BE-së:

- Direktiva 2008/56/EC 2008/56/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 17 Qershor 2008 “Për krijimin e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikave mjedisore detare”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Projektligji përmban 16 nene gjithsej.

Neni 1 përcakton objektin dhe qëllimin e ligjit.

Neni 2 trajton përkufizimet e termave.

Neni 3 trajton Strategjinë Detare të Republikës së Shqipërisë.

Pika 1, parashikon se hartimi i Strategjisë Detare duhet të përfshijë Planin e Veprimit duke përcaktuar elementet e tij.

Pika 2, përcakton elementet që duhet të përmbajë Strategjia Detare.

Pika 3, parashikon se Strategjia Detare do të zbatohet një qasje të bazuar në ekosistem për menaxhimin e veprimtarive njerëzore, duke siguruar që presioni i përbashkët i këtyre veprimtarive të jetë brenda niveleve të pajtueshme me arritjen e një statusi të mirë mjedisor dhe që aftësia e ekosistemeve detare për t'ju përgjigjur ndryshimeve të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore të mos komprometohet, duke mundësuar përdorimin e qëndrueshëm të mallrave dhe shërbimeve detare nga brezat aktualë dhe të ardhshëm.

Pika 4 përcakton institucionet përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e Strategjisë Detare.

Pika 5 parashikon përditësimin dhe rishikimin e Strategjisë.

Neni 4 trajton Planin e Veprimit të Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë.

Pika 1 përcakton autoritetet përgjegjëse për hartimin e Planit të Veprimit.

Pika 2 përcakton elementet për hartimin e Planit të Veprimit.

Pika 3 parashikon hartimin dhe miratimin e programit të masave dhe zbatimin e plotë të tij.

Pika 4 përcakton organin përgjegjës për miratimin e Strategjisë Detare.

Pika 5 trajton rastin kur statusi i ujërave është aq kritik sa kërkohet ndërmarrja e një veprimi urgjent.

Neni 5 trajton bashkëpunimin rajonal duke parashikuar se institucioni përgjegjës, kur është e mundur, mund të përdorë strukturat ekzistuese të bashkëpunimit institucional rajonal, përfshirë Konventën për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja (Konventa e Barcelonës e vitit 1976) dhe shtatë protokollat e saj.

Neni 6 trajton vlerësimin fillestar të ujërave detare.

Pika 1 trajton rregullat për vlerësimin fillestar të ujërave detare.

Pika 2 parashikon elementet që duhet të merren në konsideratë në kuadër të analizave të parashikuara për kryerjen e vlerësimit fillestar të ujërave.

Pika 3 parashikon detyrimin e institucionit përgjegjës për të siguruar që gjatë përgatitjes së vlerësimeve të statusit të ujërave detare, metodologjitë e zbatuara të jenë në përputhje me metodologjitë e shteteve të tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I dhe II, si dhe që do të merren parasysh ndikimet dhe tiparet ndërkufitare.

Pika 4 përcakton afatet për kryerjen e vlerësimit fillestar të statusit të ujërave detare.

Neni 7 trajton përcaktimin e statusit të mirë mjedisor.

Pika 1 parashikon detyrimin e institucionit përgjegjës për të identifikuar një sërë karakteristikash të statusit të tyre të mirë mjedisor, në bazë të karakteristikave cilësore të përcaktuara në zbatim të këtij projektligji.

Pika 2 parashikon se gjatë përcaktimit të statusit të mirë mjedisor të ujërave detare të nënrajonëve detare I dhe II, merren parasysh listat treguese të elementeve të përcaktuara në zbatim të këtij projektligji, dhe në veçanti, tiparet fizike dhe kimike, llojet e habitateve, tiparet biologjike dhe hidromorfologjike. Gjithashtu merr parasysh edhe presionet apo ndikimet e veprimtarisë njerëzore mbi të dy nënrajonet detare I dhe II, duke pasur parasysh listën treguese të përcaktuar në zbatim të këtij projektligji.

Pika 3 përcakton afatet dhe organin përgjegjës për përcaktimin e karakteristikave të statusit të mirë mjedisor të ujërave të nënbaseneve detare.

Neni 8 trajton përcaktimin e objektivave mjedisore.

Pika 1 parashikon detyrimin e organeve përgjegjëse që bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare, në lidhje me ujërat detare të nënrajoneve detare I dhe II, për të përcaktuar objektiva mjedisore gjithëpërfshirëse dhe treguesit e lidhur me to për monitorimin e arritjes së statusit të mirë mjedisor në mjedisin detar. Për përcaktimin e këtyre objektivave do të merret parasysh lista treguese e presioneve dhe ndikimeve, si dhe lista treguese e karakteristikave.

Pika 2 parashikon detyrimin e organeve përgjegjëse për të garantuar zbatimin e të gjithë objektivave mjedisore ekzistuese të përcaktuara në përputhje me legjislacionin shqiptar, të Bashkimit Evropian dhe atë ndërkombëtar në lidhje me ujërat e nënrajoneve detare I dhe II, duke siguruar që këto objektiva të jenë të koordinuara, si dhe që ndikimet përkatëse ndërkufitare dhe tiparet ndërkufitare të jenë marrë gjithashtu në konsideratë, për aq sa është e mundur.

Pika 3 parashikon afatet për përcaktimin e objektivave mjedisore dhe treguesit për monitorimin e arritjeve të tyre.

Neni 9 trajton programin e monitorimit.

Pika 1 parashikon hartimin e një programi ose disa programeve monitorimi për vlerësimin e vazhdueshëm të statusit mjedisor të këtyre ujërave, bazuar në vlerësimin fillestar të statusit të ujërave detare në nënrajonet detare I dhe II, të kryer këtij projektligji, duke u mbështetur në listat treguese të elementeve dhe listën përkatëse të kërkesave dhe objektivat mjedisore të përcaktuara në zbatim të këtij projektligji.

Pika 2 parashikon detyrimin e organeve përgjegjëse që gjatë hartimit të programit të monitorimit, të bashkëpunojë në rajon, me qëllim që të sigurojë pajtueshmërinë e vlerësimit dhe programeve përkatëse të monitorimit me ato të shteteve me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi nënrajonet detare I dhe II, si dhe me legjislacionin që rregullon çështjet që lidhen me habitatet dhe zogjtë e egër, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Metodatat për monitorimin e ujërave të të dy nënrajoneve detare I dhe II të jenë koherente dhe rezultatet e monitorimit të jenë të krahasueshme me metodatat përkatëse të zbatuara dhe rezultatet e

arritura nga shtetet e tjera me të cilat Republika e Shqipërisë ndan sovranitetin mbi këto nënrajone detare, duke marrë gjithashtu parasysh ndikimet dhe tiparet ndërkufitare.

Pika 3 parashikon afatet për vënien në zbatim të Programit apo Programeve të Monitorimit.

Pika 4 parashikon se zbatimi i programit apo programeve të monitorimit sigurohet përmes Programeve vjetore Kombëtare të Monitorimit të Mjedisit.

Neni 10 trajton programin e masave.

Pika 1 parashikon se plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë do të përmbajë programin e masave që duhet të merren për të arritur dhe ruajtur statusin e mirë mjedisor të ujërave detare.

Pika 2 parashikon përcaktime lidhur me hartimin dhe planifikimin e masave.

Pika 3 përmban elementet që duhet të merren në konsideratë gjatë përcaktimit të masave.

Pika 4 dhe pika 5 përmbajnë parashikime për programin e masave.

Neni 11 trajton përjashtimet nga detyrimi për të arritur objektivat mjedisore dhe statusin e mirë mjedisor.

Pika 1 përcakton shkaqet kur mund të identifikohen rastet kur objektivat mjedisore dhe statusi i mirë mjedisor, në ujërat e Detit Adriatik dhe Detit Jon të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të arrihen në çdo aspekt përmes masave të marra dhe brenda afateve kohore.

Pika 2 shprehet për shqyrtimin edhe të pasojave që mund të vijnë nga mosarritja e objektivave mjedisore dhe statusi i mirë mjedisor në shtetet e tjera, në të dy nënrajonet detare I dhe II.

Pika 3 parashikon marrjen e masave të posaçme nga autoritetet përgjegjëse, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të statusit të ujërave detare të prekur nga shkaqet e përcaktuara dhe zbutjen e ndikimit negativ brenda nënrajoneve detare I dhe II ose ujërave të shteteve të tjera.

Pika 4 parashikon marrjen e masave nga autoritetet përgjegjëse në mënyrë që ndryshimet dhe shtesat të mos përjashtojnë ose çënojnë në mënyrë të pakthyeshme arritjen e statusit të mirë mjedisor në nënrajonet detare I dhe II ose ujërat detare të shteteve të tjera.

Pika 5 parashikon se masat e posaçme të përfshihen, kur është e mundur, në programin e masave.

Neni 12 trajton rastet e mosveprimit.

Pika 1 përcakton autoritetin përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e të gjithë elementëve të Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë.

Pika 2 përmban përcaktime kur nuk ndërmerret asnjë hap për ndonjë prej shkaqeve të përcaktuara.

Neni 13 trajton pjesëmarrjen e publikut.

Pika 1 parashikon detyrimin për të garantuar që të gjitha palët e interesit dhe publiku të kenë akses në informacionin mjedisor, sipas legjislacionit përkatës.

Pika 2 parashikon detyrimin për të garantuar që të gjitha palët e interesit dhe publiku të kenë mundësi për të marrë pjesë në zbatimin kërkesave të këtij ligji, duke përfshirë, kur është e mundur, organet ekzistuese të menaxhimit ose strukturat e Konventës së Barcelonës, si dhe organe të tjerë shkencore këshillimore të njohura ndërkombëtarisht.

Pika 3 parashikon organizimin e konsultimeve publike në lidhje me Strategjinë Detare.

Pika 4 parashikon se gjatë fazës së përgatitjes së dokumenteve lidhur me vlerësimin fillestar, objektivat mjedisorë, programin e monitorimit dhe programin e masave, publikohen përmbledhje të shkurtra më qëllim për t'i dhënë publikut mundësinë e komenteve mbi këto elementë të Strategjisë Detare, si dhe të gjitha ndryshimeve të saj.

Neni 14 trajton detyrimin e raportimit.

Pika 1 përmban elementet që duhet të publikohen dhe raportohen.

Pika 2 përmban parashikime lidhur me informimin dhe raportimin e çdo ndryshimi të informacionit që përmbahet në listat e përmendura.

Pika 3 përmban parashikime për rastet kur gjykohet që një çështje që ka ndikim në statusin mjedisor të ujërave të nënrajoneve detare I dhe II të Republikës së Shqipërisë nuk mund të trajtohet nga masat e marra nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, ose nëse ekziston një rast që lidhet me zbatimin e ndonjë politike tjetër të Bashkimit Evropian apo që lind nga zbatimi i një marrëveshje ndërkombëtare.

Pika 4 përcakton afatet brenda të cilave përgatitet një raport i ndërmjetëm ishkuruar, i cili përshkruan progresin e arritur në zbatimin e programit të masave.

Neni 15 trajton aksesin dhe përdorimin e të dhënave.

Pika 1 parashikon detyrimin e autoriteteve përgjegjëse për të garantuar përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit të legjislacionit evropian për të drejtën e informacionit gjeohapësinor, të drejtën për akses dhe përdorim të të dhënave si dhe informacionit që rezulton nga vlerësimi fillestar të kryer e nga programet e monitorimit të përcaktuara në zbatim të këtij ligji.

Pika 2 përmban parashikime lidhur me vënien në dispozicion të informacionit nga vlerësimi fillestar dhe nga programet e monitorimit të përcaktuara Agjencisë Evropiane të Mjedisit.

Neni 16 trajton metodologjinë për hartimin e Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë.

Pika 1 përcakton elementet që përfshihen në metodologjinë për hartimin e Strategjisë Detare.

Pika 2 përcakton afatin dhe organin përgjegjës për miratimin e metodologjisë për hartimin e Strategjisë Detare të Republikës së Shqipërisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI.

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e detyrave që përcaktohen në dispozitat e këtij projektligji janë Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, strukturat e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, bujqësinë, dhe financën.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Transpozimi i direktivës së mësipërme ka qenë pjesë e projektit EUSIWM “Mbështetja e BE-së për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri”, në bashkëpunim me Agjencinë Austriake për Zhvillim.(ADA). Ekspertët e projektit hartuan draftin fillestar të ligjit për implementimin e kësaj direktive dhe VKM-së përkatëse në zbatim të tij. Në raportin fillestar u parashikua që projekti do të përgatisë hapat që duhen ndjekur për përmirësimin e legjislacionit shqiptar sipas kërkesave të BE-së. Në zbatim të këtij raporti ekspertët e projektit kanë hartuar dispozitat ligjore që përafrojnë plotësisht legjislacionin shqiptar me direktivën e BE-së Kuadër për Strategjinë Detare si dhe aktin nënligjor në zbatim.

Sigurimi i mbrojtjes së ujërave detare me qëllim arritjen e statusit të mirë mjedisor përbën një çështje që nuk lidhet vetëm me përgjegjësinë e AMBU-së por dhe të institucioneve të tjera. Për këtë qëllim u vlerësua e nevojshme ngritja e një Grupi Pune me Urdhrin nr.24 prot., datë 9.02.2021, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”. Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e paketës ligjore i kryesuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore kishte në përbërje përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Në vijim të takimeve të Grupit të Punës u arrit konsolidimi i këtij projektligji.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Ky ligj duke synuar të përafrojë plotësisht direktivën e BE-së Kuadër Për Startegjinë Detare parashikon dhe afate për zbatimin e dispozitave të tij. Me qëllim përmbushjen e këtyre detyrimeve kërkohet dhe një parashikim i buxhetit për arritjen e tyre. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren e Këshillit të Ministrave, projektligji do të shoqërohet dhe me vlerësimin e shpenzimeve buxhetore dhe efektet financiare të pritshme. Aktualisht me mbështetjen e projektit është në proces hartimi Raporti i Vlerësimit të projektligjit, i cili do të përmbajë edhe parashikimet lidhur me kostot e nevojshme për zbatimin e këtij projektligji.